



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 61, datë 30.06.2020

**PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1'050'000 LEKË PA TVSH, PËR
BLERJEN E DY TUNELEVE DEZINFEKTUES, TË CILËT DO TË VENDOSEN NË
HYRJEN KRYESORE TE BASHKISË DURRËS DHE QËNDRËS KULTURORE
“ALEKSANDËR MOISIU”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar, VKB nr.647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022”, Vendimit nr. 2, datë 24.03.2020 të Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës, dhe VKB nr.15, datë 30.03.2020 “Për miratimin e fondit të emergjencës civile të Bashkisë Durrës me vlerë 45'000'000 lekë për vitin 2020” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Shtabi Koordinues në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 1'050'000 lekë pa tvsh, për blerjen e dy tuneleve dezinfektues, të cilët do të vendosen në hyrjen kryesore të Bashkisë Durrës dhe Qendrën Kulturore “Aleksandër Moisiu”, detajuar si mëposhtë vijon:
 - Tunel dezinfektues (me mekanizma smart), sasia do të jetë 2 (dy) pajisje, me vlerë totale 1'050'000 lekë pa tvsh.

2. Vlera e sipërcituar do të merret nga fondi i emergjencës civile të Bashkisë Durrës miratuar me VKB nr. 15, date 30.03.2020 “Për miratimin e fondit të emergjencës civile të Bashkisë Durrës me vlerë 45'000'000 lekë për vitin 2020”.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.07.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 586/prot.
6



Durrës, më 06.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.61 datë 30.06.2020 Për miratimin e përdorimit të fondit prej 1'050'000 lekë pa tvsh, për blerjen e dy tuneleve dezinfektues, të cilët do të vendosen në hyrjen kryesore të bashkisë Durrës dhe qendrës kulturore "Aleksandër Moisiu".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

